

PARLAMENTI KROAT

1665

Në zbatim të nenit 89 të Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, miratoj

VENDIMIN

PËR SHPALLJEN E LIGJIT PËR KONTROLLIN E TREGTISË SË MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE JOUSHTARAKE VDEKJEPRURËSE.

Me anë të këtij vendimi, shpall ligjin "Për kontrollin e transportit të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse, të miratuar nga Parlamenti Kroat në seancën e datës 21 qershor 2013.

Kategoria: 011-01/13-01/156

Numri i regjistrimit: 71-05-03/1-13-2

Zagreb, më 24 qershor 2013

Presidenti

i Republikës së Kroacisë

Ivo Josipović, m.p

LIGJ

PËR KONTROLLIN E MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE JOUSHTARAKE VDEKJEPRURËSE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1.

Ky ligj rregullon kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse, duke përfshirë aktivitetet përpara, gjatë dhe pas lëshimit të autorizimeve për eksport, eksport të përkohshëm, import, import të përkohshëm, ofrim shërbimesh dhe transport dhe transferim të produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian, si dhe kompetencat e organeve të administratës shtetërore në zbatim të këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet e eksportuesve, importuesve, furnizuesve dhe marrësve e ofruesve të shërbimeve, kushtet për kryerjen e veprimtarive të përcaktuara me këtë ligj, masat administrative, kundërvajtjet dhe veprat penale në rastet e shkeljeve të dispozitave të ndryshme të këtij ligji.

Harmonizimi me rregulloret e Bashkimit Evropian

Neni 2.

Ky ligj përmban dispozita të cilat janë në përputhje me aktet e mëposhtme të Bashkimit Evropian:

1. Direktiva 2009/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 majit 2009 Për lehtësimin e kushteve të transportit të produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian (Fletorja Zyrtare L 146, 10. 6. 2009);

2. Direktiva e Komisionit 2012/47/BE e 14 dhjetorit 2012 që ndryshon Direktivën 2009/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit PËR listën e produkteve të mbrojtjes (Fletorja Zyrtare L 31, 31. 1. 2013);
3. Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2008/944/PPJS i 8 dhjetorit 2008 për përcaktimin e rregullave të përbashkëta për kontrollin e eksporteve të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake (Fletorja zyrtare L 335, 13. 12. 2008);
4. Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2003/468/PPJS i 23 qershorit 2003 për kontrollin e ndërmjetësimit të tregtisë së armëve (SL L 31, 31.1.2013);
5. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2000/401/PPJS i 22 qershorit 2000 për kontrollin e asistencës teknike lidhur me lloje të caktuara të përdorimeve fundore ushtarake (Fletorja zyrtare L 159, 30.6.2000);
6. Lista e përbashkët e produkteve të mbrojtjes e Bashkimit Evropian, e cila përfshin edhe pajisjet sipas Qëndrimit të Përbashkët të Këshillit 2008/944/PPJS (Fletorja zyrtare C 90, 27.3.2013);
7. Rekomandimi i Komisionit i 11 janarit 2011 për certifikimin e kompanive të mbrojtjes sipas nenit 9 të Direktivës 2009/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për lehtësimin e kushteve për transportimin e produkteve të mbrojtjes brenda Komunitetit (Fletorja zyrtare L 11, 15.1.2011).

Neni 3

Shprehje të veçanta në kuptim të këtij ligji kanë kuptimet e mëposhtme:

1. "*Transport*" është eksporti, eksporti i përkohshëm, importi, importi i përkohshëm, ofrimi i shërbimeve dhe transferimi dhe transiti brenda Bashkimit Evropian.
2. "*Mallra ushtarake*" janë mallrat të cilat janë krijuar, prodhuar, prodhuar, montuar ose modifikuar kryesisht, por jo vetëm, për përdorim ushtarak, përfshirë edhe teknologjitë dhe softueri lidhur me këto mallra dhe të cilat janë përfshirë në listën e mallrave ushtarake.
3. "*Mallra joushtarake vdekjeprurëse*" janë mallrat e përfshira në listën e mallrave *joushtarake vdekjeprurëse* për qëllime tregtare.
4. "*Produkte homogjene*" janë produktet e të njëjtës kategori ML, me të njëjtin emërtim dhe të krijuara për të njëjtin qëllim.
5. "*Markimi ML*" përcakton një kategori të veçantë mallrash ushtarake nga lista e përbashkët e mallrave ushtarake e Bashkimit Evropian në të cilën kategoritë etiketohen me markimet ML1 deri në ML22 (shkurtimi ML vjen nga fjala anglisht *Military List*, që do të thotë lista e mallrave ushtarake).
6. "*Eksport*" është procedura e rregullt doganore që zbatohet për mallrat që nxirren, përgjithmonë ose përkohësisht, jashtë territorit të Republikës së Kroacisë, duke përfshirë dhe riekportimin e këtyre mallrave. Fjala "*eksport*" nënkupton edhe transmetimin e programit kompjuterik dhe të teknologjisë nëpërmjet mediave elektronike, faksit ose telefonit në destinacione jashtë Republikës së Kroacisë, duke përfshirë edhe transmetimin verbal të teknologjisë nëpërmjet telefonit, por kjo vetëm nëse teknologjia përmbahet në një dokument pjesa kryesore e të cilit është komunikuar nëpërmjet telefonit ose është përshkruar nëpërmjet telefonit në mënyrë që të arrihet i njëjti rezultat; transferimi i produkteve të mbrojtjes nga një furnizues në Republikën e Kroacisë të një marrë në një shtet tjetër anëtar i Bashkimit Evropian nuk konsiderohet eksport.

7. "*Eksportues*" është personi fizik ose juridik – një tregtar i vetëm i vendosur në Republikën e Kroacisë, i cili është regjistruar për kryerjen e aktivitetit të tregtimit dhe është regjistruar në regjistrin e eksportuesve dhe importuesve.

8. "*Import*" është procedura e rregulluar doganore që zbatohet për mallrat që futen përgjithmonë ose përkohësisht në territorin e Republikës së Kroacisë, duke përfshirë riimportimin; transferimi i produkteve të mbrojtjes nga furnizuesit në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian të një marrësi në Republikën e Kroacisë, nuk konsiderohet import.

9. "*Importues*" është personi fizik ose juridik – një tregtar i vetëm i vendosur në Republikën e Kroacisë, i cili është regjistruar për kryerjen e aktivitetit të tregtimit dhe është regjistruar në listën e eksportuesve dhe importuesve. Importues mund të jetë dhe një person fizik- një shtetas që importon mallra për nevojat e tij në bazë të miratimit të blerjes nga Ministria e Punëve të Brendshme.

10. "*Autorizim*" është një akt i veçantë i lëshuar nga organi kompetent pas kërkesës me shkrim në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

11. "*Shërbime*" janë marrja e përfitimeve, transferimi i të drejtave dhe aktiviteteve të tjera tregtare të lidhura me mallrat ushtarake, duke përfshirë edhe shërbimet e ndërmjetësve dhe asistencën teknike.

12. "*Shërbime ndërmjetësimi*" janë negociatat ose marrëveshjet për blerje, shitje ose prokurim të mallrave ushtarake të specifikuar në listën e mallrave ushtarake të përmendur në nenin 4 të këtij ligji nga një shtet i huaj në çfarëdo shteti tjetër të huaj; shitja dhe blerja e mallrave ushtarake të përfshira në listën e mallrave ushtarake të përmendur në nenin 4 të këtij ligji që gjenden në një shtet të huaj për t'i transferuar në një shtet tjetër të huaj. Shërbimet ndihmëse nuk konsiderohen shërbime ndërmjetësimi. Shërbimet ndihmëse përfshijnë transportin, shërbimet financiare, shërbimet e sigurimit ose risigurimit dhe reklamimin ose promovimin.

13. "*Ndërmjetës*" është personi juridik ose fizik-tregtari i vetëm i vendosur në Republikën e Kroacisë i cili merret me shërbimet e ndërmjetësimit.

14. "*Asistencë teknike*" është çdo mbështetje teknike në lidhje me riparimin, zhvillimin, prodhimin, montimin, testimin ose mirëmbajtjen e mallrave ushtarake dhe çdo asistencë tjetër lidhur me mallrat ushtarake në formën e udhëzimeve, aftësimin, transmetimit të njohurive rreth punës ose shërbimet të specializuara ose të konsulencës. Asistenca teknike përfshin asistencën verbale, udhëzimet me shkrim ose verbale, kurset e aftësimin, komunikimi i njohurive në lidhje me punën ose i ekspertizës, ose shërbimet e konsulencës.

15. "*Të disponueshme për publikun*" janë teknologjitë ose programet kompjuterike të disponueshme për përdorim nga publiku pa kufizim të shpërndarjes së mëtejshme të tyre.

16. "*Kërkime shkencore bazë*" janë kërkimet eksperimentale ose teorike që kryhen për të mësuar të dhëna të reja rreth parimeve themelore të fenomeneve ose fakteve të vërejtura dhe të cilat nuk fokusohen drejtpërdrejt në një qëllim specifik ose zbatim në praktikë.

17. "*Produkte të mbrojtjes*" janë të gjitha produktet e përmendura në listën e produkteve të mbrojtjes të përcaktuar nga Komisioni Evropian.

18. "*Transferim*" është çdo transferim ose lëvizje e produkteve të mbrojtjes nga një furnizues në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian të një marrësi në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

19. "*Marrja e produkteve të mbrojtjes*" është një aktivitet i lidhur me transferimin, i cili përfaqëson një transfertë ose lëvizje të produkteve të mbrojtjes nga furnitori në një shtet të Bashkimit Evropian të marrësi në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

20. "*Furnizues*" është një person juridik ose fizik- tregtar i vetëm me seli brenda Bashkimit Evropian, i cili është ligjërisht përgjegjës për transferimin:

21. "*Marrës*" është personi juridik ose fizik-tregtar i vetëm- me seli brenda Bashkimit Evropian, i cili është ligjërisht përgjegjës për marrjen e produkteve të mbrojtjes.

22. "*Autorizim për transferim*" është autorizimi që lëshuar nga organi kompetent furnitorëve në Republikën e Kroacisë për transferim të produkteve të mbrojtjes të një marrës në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian ose të një marrës në Republikën e Kroacisë, në rast transferimi të produkteve të mbrojtjes nga një shtet tjetër anëtar i Bashkimit Evropian.

23. "*Autorizim i përgjithshëm për transferim*" është autorizimi me anë të të cilit furnizuesve dhe marrësve të produkteve në territorin e Republikës së Kroacisë që përmbushin kushtet e përcaktuara në autorizim, lejohen që të transferojnë produktet e mbrojtjes të specifikuar në autorizim të marrësit ose furnizuesit e vendosur në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian

24. "*Autorizim global për transferim*" është autorizimi për transferimin e produkteve të mbrojtjes të marrësit në një ose më shumë vende të Bashkimit Evropian, si dhe autorizimi për transferim të produkteve të mbrojtjes nga furnizues në një ose më shumë vende të Bashkimit Evropian.

25. "*Autorizim individual për transferim*" është autorizimi me të cilin lejohet transferimi i një sasive të caktuar produktesh të mbrojtjes, në një ose disa dërgesa, të një marrës në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian ose nga një furnizues në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

26. "*Transit brenda Bashkimit Evropian*" është transporti i produkteve të mbrojtjes përmes një ose më shumë shteteve të Bashkimit Evropian, një shteti joanëtar të origjinës së produkteve të mbrojtjes ose shtetit anëtar të marrësit.

Neni 4.

Qeveria e Republikës së Kroacisë (në vijim: Qeveria), me propozim të ministrisë kompetente për fushën e ekonomisë (në vijim: Ministria) miraton listën e mallrave ushtarake në përputhje me listën e përbashkët ushtarake të Bashkimit Evropian, si dhe listën e mallrave joushtarake për qëllime tregtare.

II. KOMPETENCAT PËR TË VEPRUAR

Neni 5.

(1) Eksporti dhe importi i mallrave, ofrimi i shërbimeve sipas nenit 3 pika 11 të këtij ligji, si dhe transferimi i produkteve të mbrojtjes mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian kryhet në bazë të autorizimeve.

(2) Autorizimet për eksport dhe import të mallrave, ofrimi i shërbimeve dhe transferimi i produkteve të mbrojtjes mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian lëshohen nga Ministria, në bazë të miratimit të Komisionit për dhënien e autorizimeve për eksport dhe import të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse, transferimin e produkteve të mbrojtjes, si dhe ofrimin e shërbimeve për mallrat ushtarake (në vijim: Komisioni). Komisioni përbëhet nga përfaqësuesit e ministrive kompetente për mbrojtjen, punët e brendshme, punët e jashtme, doganat dhe ekonominë.

(3) Miratimi sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet me vendim unanim të të gjithë anëtarëve të Komisionit. Në rast mungese të ndonjërit prej anëtarëve të Komisionit, të drejtën e votës e ka anëtari që e zëvendëson atë.

(4) Në punimet e Komisionit çdo anëtar ose zëvendësi i tij është kompetent për çështjet e fushës së veprimtarisë së ministrisë që ai përfaqëson.

(5) Nëse disa nga anëtarët e Komisionit nuk kanë mundësi që ta japin miratimin për eksportin e kërkuar brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e mbledhjes së Komisionit, ndërkohë që nuk kanë marrë vendim për refuzimin e kërkesës, ministri kompetent për ekonominë (në vijim referuar si: Ministri) u kërkon ministrave kompetentë deklaratë me shkrim mbi kërkesën në fjalë.

(6) Komisioni sipas paragrafit 2 të këtij neni emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga ministri, me propozimi të ministrave kompetentë të mbrojtjes, punëve të brendshme, punëve të jashtme, doganave dhe ekonomisë dhe përbëhet nga një anëtar dhe një zëvendës i anëtarit nga çdo ministri kompetente. Kryetari i Komisionit dhe zëvendësi i tij janë anëtarë nga Ministria.

(7) Komisioni harton rregulloren procedurale.

Neni 6.

Bëjnë përjashtim nga neni 5 paragrafi 2 i këtij ligji:

– Ministria e Mbrojtjes lëshon autorizim importi për nevojat e forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, ndërsa Ministria e Brendshme lëshon autorizim për import të mallrave për nevojat e policisë.

– Ministria e Mbrojtjes lëshon autorizim për eksport mallrash me qëllimin për t'i kthyer sërish në shtetin tonë për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme lëshon autorizim për eksport mallrash, me qëllim të kthimit të tyre në shtetin tonë për nevojat e policisë.

– autorizimet për eksport mallrash në bazë të donacioneve të qeverisë lëshohen nga ministria kompetente për punët e brendshme, në rast se bëhet fjalë për mallra që janë kompetencë e saj.

– autorizimet për eksport mallrash në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare ushtarake nënshkrues i të cilave është Republika lëshohen nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 7.

(1) Ministria lëshon autorizim të veçantë për çdo eksport ose import, me afat vlefshmërie deri në një vit pa të drejtë rinovimi.

(2) Duke bërë përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria mund të lëshojë autorizim të veçantë për eksport ose import me afat më të gjatë se një vit, por jo më shumë se tre vjet, në rastin e eksportit të përkohshëm ose importit të mallit për remontin ose riparimin e të cilit duhet një afat më i gjatë se një vit.

(3) Ministri përcakton formën dhe përmbajtjen e autorizimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 8.

(1) Duke bërë përjashtim nga neni 7 paragrafi 1 i këtij ligji, Ministria mund të lëshojë autorizime globale eksporti, për eksportin e mallrave ushtarake homogjene të synuara për një ose më shumë shtete, por duke marrë parasysh llojin e mallit dhe kohëzgjatjen e punëve të eksportit të shtetit ku eksportohet ky mall.

(2) Autorizimi global i eksportit mund të lëshohet vetëm për eksport të pajisjeve të blinduara ose mbrojtëse, konstruksioneve dhe komponentëve nga kategoria ML13 të listës së mallrave ushtarake të përmendur në nenin 4 të këtij ligji, për nevoja tenderi, testimi, ekspozitash ose prezantimi, me afat vlefshmërie deri në një vit dhe pa të drejtë zgjatjeje.

(3) Ministri përcakton formën dhe përmbajtjen e autorizimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 9.

(1) Me kërkesë të importuesit, në bazë të deklaratës me shkrim mbi përdoruesin e fundor dhe qëllimit të importimit të mallit, së bashku me autorizimin e importit, Ministria lëshon edhe certifikatën e përdoruesit fundor.

(2) Nëse importuesi është i ndryshëm nga përdoruesi fundor, përveç dokumenteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të bashkëlidhet edhe deklaratata e përdoruesit të fundor në lidhje me llojin, sasinë dhe qëllimin e mallit.

(3) Certifikatat e përdoruesit fundor për importimin e mallrave për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë lëshohen nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen ose ministria përgjegjëse për punët e brendshme.

(4) Ministri përcakton formën dhe përmbajtjen e autorizimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 10.

(1) Eksporti dhe importi i mallrave sipas këtij ligji mund të kryhet nga personat juridikë dhe fizikë-tregtarët (në vijim referuar si: personat), të cilët janë regjistruar për kryerjen e veprimtarisë së tregtimit të mallrave dhe janë regjistruar në regjistrin e eksportuesve dhe të importuesve të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (në vijim: Regjistri).

(2) Duke deroguar nga neni 1 i këtij ligji, personi fizik-qytetari mund të importojë për nevojat e tij, pa regjistrim në regjistër, mallra për të cilat ministria kompetente për punët e brendshme ka lëshuar autorizim për blerje arme.

(3) Personit fizik-qytetarit nuk i lejohet të eksportojë mallra ushtarake dhe mallra joushtarake vdekjeprurëse.

(4) Personat fizikë vendas dhe të huaj –qytetarët, të cilët vijnë përkohësisht në Republikën e Kroacisë ose dalin përkohësisht jashtë shtetit mundën që të fusin ose të nxjerrin mallra që nevojiten për kohën e qëndrimit në Republikën e Kroacisë ose jashtë shteti, në përputhje me këtë ligj, rregullat doganore dhe rregulla të tjera dhe me marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare.

(5) Malli sipas paragrafit 4 të këtij neni mund të përdoret vetëm për qëllimet për të cilat është futur ose është nxjerrë nga territori.

(6) Përpara fillimit të veprimtarisë së eksportit ose të importit, personat sipas paragrafit 1 të këtij neni janë aplikojnë për regjistrim në regjistrin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

(7) Regjistri sipas paragrafit 1 të këtij neni mbahet nga Ministria.

(8) Ministri përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 11.

(1) Regjistrimi në regjistrin sipas nenit 10 të paragrafit 1 të këtij ligji kryhet në bazë të kërkesës me shkrim, të vërtetuar me vulë dhe me nënshkrimin e vetë personit përgjegjës të personit juridik ose të personit fizik-tregtarit.

(2) Parashtruesi i kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij ligji duhet të bashkëlidhë me kërkesën dokumentacionin e mëposhtëm:

- një kopje të vendimit të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme që miraton kryerjen e veprimtarisë së prodhimit/tregtimit të armëve dhe municioneve ose të lëndëve plasëse.
 - një kopje të vendimit të organit kompetent në lidhje me regjistrimin e veprimtarisë së tregtimit të mallrave.
 - numrin personal të identifikimit të personit të përmendur në nenin 10 paragrafi 1 të këtij ligji.
 - vërtetimin e organit kompetent që konfirmon se personi juridik dhe personi përgjegjës i personit juridik ose personit fizik-tregtarit nuk është në ndjekje penale për veprime të kundërligjshme me mallrat ushtarake dhe mallrat joushtarake vdekjeprurëse sipas neneve 84 dhe 85 të këtij ligji, të lëshuar brenda gjashtë muajve të fundit.
 - emrin e bankës dhe dokumentet e vërtetuara nga banka klient i të cilës është i (fotokopje të bilancit dhe të llogarisë së fitimeve humbjeve, vërtetim që personi nuk është bllokuar gjatë gjashtë muajve të fundit, fotokopjen e kartës së nënshkrimeve të depozituara).
 - deklaratën mbi numrin dhe strukturën e të punësuarve.
 - Deklaratë me të cilën personi përgjegjës në personin juridik ose personi fizik-tregtari garanton se do të lejojë organi kompetent të kontrollit që të kontrollojë të dhënat lidhur me eksportin dhe importin, si dhe kontrollin e ambienteve të depozitimit dhe mjeteve të transportit.
- (3) Fotokopja e vendimit sipas paragrafit 2 nënparagrafi 1 të këtij neni nuk është e nevojshme të dorëzohet nëse personi dorëzon deklaratën se nuk do merret me prodhim ose tregtim të armëve ose lëndëve plasëse.
- (4) Në bazë të dokumentacionit të paraqitur sipas paragrafit 2 të këtij neni, Ministria i kërkon ministrisë kompetente për çështjet e drejtësisë që të verifikojë të dhënat nga regjistri gjyqësor se ndaj personi juridik, personi përgjegjës i personit juridik ose personit fizik-tregtarit nuk është ngritur asnjë padi më parë dhe as nuk është dhënë ndonjë vendim penal i formës së prerë për veprime të kundërligjshme me mallrat ushtarake dhe mallrat joushtarake vdekjeprurëse sipas neneve 84 dhe 85 të këtij ligji.
- (5) Ministri merr vendimin mbi regjistrimin në regjistrin e përmendur në nenin 10 paragrafi 1 të këtij ligji.
- (6) Vendimi sipas paragrafit 5 të këtij neni nuk mund të ankimohet, por mund të paraqitet për gjykim administrativ.

Neni 12.

Personi i regjistruar në regjistrin e përmendur në nenin 10 paragrafi 2 të këtij neni duhet të njoftojë me shkrim të gjitha ndryshimet në të dhënat sipas nenit 11 paragrafi 2 i këtij ligji, brenda 15 ditëve nga dita e kryerjes së ndryshimit.

Neni 13.

(1) Ministria, me anë të një vendimi, e kundërshton regjistrimin në regjistrin sipas nenit 10 paragrafi 1 të këtij ligji në rast se:

- janë paraqitur informacione ose dokumente të rreme,
- aplikanti ka shkelur dispozitat ligjore për tregtinë e mallrave ushtarake ose mallrave joushtarake vdekjeprurëse, gjatë 10 viteve të fundit,

- aplikanti ka shkelur sanksionet ndërkombëtare, gjatë 10 vitet e fundit,
- aplikanti po hetohet nga policia për shkelje ligjore që lidhen me mallrat ushtarake ose me mallrat joushtarake vdekjeprurëse,
- aplikanti është nën hetim ose ndjekje penale për veprime të paligjshme me mallrat ushtarake ose mallrat joushtarake vdekjeprurëse të përmendura në nenin 84 dhe 8. të këtij ligji,
- kundër këtij personi është ngritur padi ose ai qenë dënuar me burgim për shkelje që lidhen me mallrat ushtarake ose mallrat joushtarake vdekjeprurëse të përmendura në nenin 84 dhe 85 të këtij ligji,
- ekziston një dyshim arsyeshëm ose vërtetohet se personi juridik ose personi përgjegjës i personit juridik apo personit fizik-tregtarit ose një person tjetër i punësuar nga personi juridik ose tregtari ka negociuar ose ka lidhur kontratë me ndonjë person, kompani ose organizatë për të cilën është vërtetuar ose ekzistojnë dyshime të arsyetuara se është përfshirë ose ka bashkëpunuar në ndonjë mënyrë në aktivitete të paligjshme me mallra ushtarake ose mallra joushtarake vdekjeprurëse,
- ekzistojnë arsye të tjera të arsyeshme.

(2) Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të ankimohet, por mund të paraqitet për gjykim administrativ.

Neni 14.

(1) Personi sipas nenit 10 paragrafi 1 i këtij ligji do të hiqet nga regjistri kur:

- zbulohen fakte të reja dhe/ose rrethana të cilat, nëse do të disponoheshin në momentin e regjistrimit në regjistër, do të pengonin regjistrimin e personit në regjistër,
- kundër personit ose personit përgjegjës të personit juridik, ose kundër personit fizik-tregtarit ka nisur një proces hetimor për veprime të paligjshme me mallra ushtarake ose mallra joushtarake vdekjeprurëse,
- personi përgjegjës i personit juridik ose personit fizik-tregtarit është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale që lidhen me pronësinë ose kundër tij është dhënë apo është duke u zbatuar një masë sigurie që e ndalon atë të kryejë ose të përfshihet në veprimtari që janë përfshirë plotësisht ose pjesërisht në objektin e veprimtarisë së tij tregtare.
- nuk punon në përputhje me dispozitat e këtij ligji,
- shkel sanksionet ndërkombëtare,
- ndërpret aktivitetin e tij,
- Nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave është lëshuar vendimi për regjistrim në regjistër,
- ekzistojnë dyshime të arsyetuara ose vërtetohet se personi juridik ose personi përgjegjës i personit juridik apo personit fizik-tregtarit, ose një person tjetër i punësuar nga personi juridik ose tregtari, ka negociuar ose ka lidhur kontratë me një person, kompani ose organizatë për të cilën është vërtetuar ose ekzistojnë dyshime të arsyetuara se është i përfshirë ose ne çfarëdo lloj mënyre ka bashkëpunuar në veprime të paligjshme që lidhen me mallra ushtarake ose mallra joushtarake vdekjeprurëse,
- kërkohet nga personi i regjistruar në regjistër.

(2) Vendimi për heqjen e personit nga regjistri i përmendur në nenin 10 paragrafi 1 të këtij ligji merret nga ministria.

(3) Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të ankimohet, por mund të paraqitet për gjykim administrativ.

III. PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR AUTORIZIM EKSPORTI DHE IMPORTI

Neni 15

(1) Kërkesa për lëshim autorizimi për eksport ose import të mallrave i paraqitet ministrisë, me shkrim.

(2) Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të bëhet për mallra që i përkasin vetëm një kategorie tarifore, pra vetëm një kategorie ML nga lista e mallrave ushtarake.

(3) Duke deroguar nga paragrafi 2 i këtij neni, kërkesa mund të përmbajë mallra nga disa kategori tarifore ose markimi ML kur bëhet fjalë për import ose eksport për qëllime ekspozimi. Ky autorizim emërtohet vetëm për një eksportues ose importues.

(4) Së bashku me kërkesën për eksport të mallrave ushtarake ose mallrave joushtarake vdekjeprurëse, duhet të bashkëlidhen edhe autorizimi për import i lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku eksportohet malli, si dhe kopja origjinale e certifikatës së përdoruesit fundor e lëshuar ose e vërtetuar nga organi kompetent i shtetit të përdoruesit fundor.

(5) Nëse shteti i përdoruesit fundor të mallit është i ndryshëm nga shteti i importuesit, përveç dokumenteve sipas paragrafit 4 të këtij neni, kërkesës duhet t'i bashkëlidhen edhe fotokopja e noterizuar e certifikatës së përdoruesit fundor të mallit e lëshuar nga organi kompetent i shtetit të përdoruesit fundor, duke treguar edhe origjinalen.

(6) Autorizimi për importin sipas paragrafit 4 të këtij neni nuk është nevoja që të bashkëlidhet me kërkesën për eksport nëse organi kompetent i shtetit importues lëshon vërtetim që për mallin në fjalë nuk kërkohet të merret autorizim import në shtetin.

(7) Certifikata e përdoruesit fundor sipas paragrafit 4 të këtij neni nuk është e nevojshme që të bashkëlidhet me kërkesën për eksport nëse bëhet fjalë për eksport të përkohshëm për qëllime ekspozimi, seminaresh, trajnimi, testimi, demonstrimi ose riparimi të mallit nga prodhuesi dhe kthim të mallit me defekt te prodhuesi, si dhe në rastin e eksportit të mostrave të pajisjeve të blinduara ose mbrojtëse, konstruksioneve dhe komponentëve të kategorisë ML13 të listës së mallrave ushtarake sipas nenit 4 të këtij ligji.

(8) Ministri përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit sipas paragrafit 1 të këtij neni, si dhe listën e dokumenteve që i duhen bashkëlidhur kërkesës.

Neni 16.

Komisioni merr një vendim për kërkesën e përmendur në nenin 15 paragrafi 1 të këtij ligji 15 ditësh pas dorëzimit ose brenda 45 ditësh pas dorëzimit, nëse për procedurën e lëshimit të autorizimit kërkohen verifikime shtesë.

Neni 17.

(1) Ministria e lëshon autorizimin e kërkuar sipas nenit 16 të këtij ligji brenda shtatë ditësh nga marrja e miratimit nga Komisioni.

(2) Ministria nuk do të shpjegojë shkaqet e kundërshtimit të kërkesës nëse ato bazohen në informacion i cili me ligj ose në bazë të kriterëve të konfirmuara me ligj klasifikohen me një shkallë të caktuar konfidencialiteti ose nëse është informacion i mbrojtur nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

(3) Nëse Komisioni nuk pranon ta miratojë kërkesën e parashtruar sipas nenit 15 paragrafi 1 të këtij ligji, Ministria merr një vendim për refuzim të kërkesës, i cili nuk mund të ankimohet por mund paraqitet për gjykim administrativ.

Neni 18.

Autorizimi dhe dokumentet e tjera të marra në bazë të këtij ligji nuk mund tu transferohen personave të tjerë.

Neni 19.

(1) Në rastin e importit të mallrave për t'i eksportuar në një shtet të tretë, aplikanti, me kërkesë të Ministrisë, duhet t'i bashkëlidhë kërkesës për autorizim eksporti edhe miratimin e organit kompetent të shtetit të origjinës së mallrave ose të shtetit të importit të mallrave që lejon eksportimin e tyre në një shtet të tretë.

(2) Në rastin e eksportit të mallrave të cilat kanë qenë importuar, Ministria mund t'i kërkojë aplikantit që bashkë me kërkesën për eksport të bashkëlidhë edhe miratimin e ndryshimit të përdoruesit fundor të mallrave të lëshuar nga organi kompetent i shtetit të importit, për verifikimin e vërtetësisë ose të vlefshmërisë ligjore.

Neni 20.

Nëse ekzistojnë dyshime të arsyeshme për vërtetësinë ose vlefshmërinë ligjore të dokumentacionit të bashkëlidhur, ministria me propozim të Komisionit, ia përcjell atë organeve kompetente për përpunim të mëtejshëm, për qëllime të konfirmimit të besueshmërisë dhe vlefshmërisë ligjore të tyre.

Neni 21.

(1) Ministria e refuzon kërkesën për lëshim të autorizimi për eksport ose import nëse Komisioni nuk e miraton atë për shkak se ka konstatuar që lëshimi i autorizimit të kërkuar do të ishte në kundërshtim me interesat e politikës së jashtme ose interesat ekonomike të Republikës së Kroacisë, ose nëse është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dokumentin e përmendur në nenin 2 pika 3 të këtij ligji, si dhe në rastet e mëposhtme, kur:

– lëshimi i autorizimi do të rrezikonte përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Kroacisë,

– lëshimi i autorizimit do të rrezikonte sigurinë ose interesat e mbrojtjes të Republikës së Kroacisë,

– është në kundërshtim me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Kroacisë,

– lëshimi i autorizimit të eksportit mund t'u mundësojë marrjen e mallrave të eksportuara nga persona të padëshiruar, në kundërshtim me dëshirën e eksportuesit,

– vërtetohet se mall për të cilën kërkohet autorizim eksporti është objekt i hetimeve policore ose procesi gjyqësor.

(2) nëse kërkesa ka mangësi të cilat bëjnë të pamundur veprimet sipas kërkesës ose nëse ajo është e pakuptueshme ose e paplotë dhe aplikanti nuk i korrigjon mangësitë në afatin e caktuar, personi i shërbimit do ta refuzojë kërkesën.

(3) vendimi sipas paragrafit 2 të këtij neni mund të dërgohet më shkrim, përmes postës elektronike ose me verbalisht dhe do të mbahet shënim.

(4) Vendimi sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nuk mund të ankimohet, por mund të paraqitet për gjykim administrativ.

Neni 22.

Në rast se kërkohet lëshim i autorizimit për eksport në një shtet i cili është objekt i masave shtrënguese nga ana e OKB-së, BE-së, OSBE-së ose të organizatave të tjera ndërkombëtare, të miratuara nga Republika e Kroacisë, autorizimi mund të lëshohet vetëm për qëllime humanitare ose për nevoja të forcave paqeruajtëse.

Neni 23.

(1) Përpara lidhjes së një kontrate për shitje ose blerje të mallrave ushtarake ose mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare, personat sipas nenit 10 paragrafi 1 të këtij ligji mund të kërkojnë t'i kërkojnë ministrisë një mendim nëse kryerja e veprimtarisë në fjalë me një ndërmjetës, blerës, importues, përdorues fundor ose shteti i përdorimit fundor është në kundërshtim me dispozitat e nenit 21 të këtij ligji.

(2) Ministria, pas grumbullimit të informacioneve nga ana e organeve kompetente të Republikës së Kroacisë, informon personat e përmendur në nenin 10 paragrafi 1 të këtij ligji nëse ndërmjetësi, blerësi, importuesi, ose shteti i caktuar si përdorues fundor është palë e pranueshme për transaksionin e propozuar.

Neni 24.

(1) Ministria merr vendimin për revokimin e autorizimit të dhënë sipas nenit 17 paragrafi 1 i këtij ligji nëse vërtetohet se:

– nuk një ose disa kushte, mbi bazën e të cilave është lëshuar leja, nuk ekzistojnë më;

– autorizimi është lëshuar mbi bazën e të dhënave të pasakta ose të paplota dhe aplikanti ka pasur dijeni ose mund të ketë pasur dijeni që këto të dhëna janë të pasakta ose jo të plota.

– kërkohet nga pala në emër të të cilës është lëshuar autorizimi;

– është bërë në kundërshtim me nenin 18 të këtij ligji.

(2) Republika e Kroacisë nuk mban përgjegjësi për shpenzimet e shkaktuara apo që mund të shkaktohen nga heqja e autorizimit të lëshuar.

(3) Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të ankimohet, por mund të paraqitet për gjykim administrativ.

Neni 25.

(1) Ministria mban bazën e të dhënave për autorizimet e kërkuara, lëshuara, realizuara dhe të hequra, si dhe të kërkesave të refuzuara lidhur me tregtimin e mallrave dhe produkteve të mbrojtjes sipas nenit 3 të këtij ligji.

(2) Brenda datës 30 prill të vitit vijues, Ministria përgatit një raport vjetor për eksportin dhe importin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare për vitin pasardhës dhe ia dërgon për miratim qeverisë me nivelin e duhur të sigurisë.

(3) Brenda datës 30 maj të vitit vijues, ministria publikon raportin sipas paragrafit 2 të këtij neni, përveç të dhënave konfidenciale, në faqen e saj të internetit.

(4) Të dhënat konfidenciale sipas paragrafit 3 të këtij neni janë emrat e kompanive dhe disa tregues të veçantë financiarë, si dhe të dhënat e tjera në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave".

Neni 26.

Personat sipas nenit 10 paragrafi 1 të këtij ligji, të cilët kryejnë veprimtaritë e eksportit ose të importit të mallrave, kanë detyrimin që:

– të mbajnë një regjistër të veçantë për transaksionet e kryera sipas këtij ligji dhe të ruajnë dokumentacionin mbi transaksionet dhe transportimet e kryera të paktën 20 vjet pas eksportimit ose importit të kryer, të respektojnë afatet dhe kushtet me të cilat janë lëshuar autorizimet dhe të informojnë ministrinë me shkrim për çdo ndryshim të ndodhur brenda 10 ditësh nga data e ndryshimit:

– të njoftojë ministrinë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike, brenda 15 ditëve nga kryerja e eksportit ose importit, lidhur me eksportimin ose importimin e kryer dhe të bashkëlidhë dokumentacionin mbi bazën e të cilit është kryer eksporti ose importi,

– me kërkesë të Ministrisë, të konfirmojë marrjen e mallrave të importuara,

– të respektojë kushtet e autorizimit dhe dispozitat e këtij ligji.

Neni 27.

Dokumentacioni sipas nenit 26 paragrafi 2 të këtij ligji duhet të përmbajë informacion mbi eksportin e kryer, fotokopjen e autorizimit në bazë të të cilit është kryer eksporti ose importimi i mallrave, fotokopjen e deklaratës doganore, numrat serialë të armëve dhe dokumente të tjera, në varësi të llojit të mallit.

Neni 28.

Personi sipas nenit 10 paragrafi 1 të këtij ligji duhet të përfshijë në deklaratën doganore sipas nenit 27 të këtij ligji të dhënat e mëposhtme:

– emrin e plotë të eksportuesit ose importuesit,

– numrin e autorizimit për eksport ose import, në bazë të së cilit është kryer zhdoganimi,

– emrin e mallit në përputhje me emrin në autorizimin e lëshuar,

– sasinë e mallit, të shprehur në njësinë e matjes të përcaktuar në autorizim.

– vlerën e mallit, të shprehur në valutën e përcaktuar në autorizim,

– markimin e mallit,

– markimin ML nga lista e mallrave ushtarake, siç përmendet në nenin 4 të këtij ligji, nëse bëhet fjalë për këtë lloj malli.

IV. SHËRBIMET

Neni 29

- (1) Shërbimet sipas nenit 3 pika 11 të këtij ligji mund të ofrohen nga personat e regjistruar për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit ose të ndërmjetësimit, në tregun e brendshëm ose jashtë tij, të mallrave të përfshira në listën e mallrave ushtarake sipas nenit 4 të këtij ligji, me seli në territorin e Republikës së Kroacisë dhe të regjistruar në regjistrin e ofruesve të shërbimeve për mallrat ushtarake.
- (2) Shërbimet sipas nenit 3 pika 11 të këtij ligji, në territorin e Republikës së Kroacisë mund të ofrohen vetëm nga prodhuesit e mallrave të përfshira në listën e mallrave ushtarake.
- (3) Regjistri sipas paragrafit 1 të këtij neni mbahet nga ministria.
- (4) Ministri përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 30.

- (1) Regjistrimi në regjistër sipas nenit 29 paragrafi 1 të këtij ligji bëhet në bazë të kërkesës me shkrim të vulosur dhe nënshkruar nga personi përgjegjës i personit juridik ose të vulosur dhe nënshkruar nga personi fizik-tregtari.
- (2) Aplikanti sipas paragrafit 1 të këtij neni, bashkë me kërkesën duhet të bashkëlidhë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:
 - kopjen e vendimit të organit kompetent lidhur me regjistrimin e veprimtarisë tregtare të regjistruar,
 - numrin e identifikimit të personit të përmendur në nenin 10 paragrafi 1 të këtij ligji,
 - vërtetimin e organit kompetent që personi juridik dhe personi përgjegjës në personin juridik ose personi fizik-tregtari dhe ndërmjetësi nuk janë në ndjekje penale për veprime të paligjshme me mallra ushtarake ose mallra joushtarake vdekjeprurëse sipas neneve 84 dhe 85 të këtij ligji, të lëshuar brenda gjashtë muajve të fundit,
 - emrin e bankës dhe dokumentet e vërtetuara nga banka klienti të cilës është (fotokopjet e bilancit të fundit, të llogarisë së fitimit ose humbjes, vërtetimin që konfirmon se personi nuk është bllokuar gjashtë muajt e fundit, kopjen e kartës së nënshkrimeve të depozituara).
 - deklaratën mbi numrin dhe strukturën e të punësuarve,
 - deklaratën me të cilën personi përgjegjës në personin juridik ose personin fizik-tregtarin, garanton se do i mundësojë organit kompetent inspektues të inspektojë shërbimet e ofruara,
 - deklaratën me të cilën personi përgjegjës në personin juridik ose personin fizik-tregtari, autorizon një ose disa persona të punësuar që kryejnë shërbimet e ndërmjetësimit në emër dhe për llogari të kompanisë.
- (3) Në bazë të dokumentacionit të paraqitur sipas paragrafit 2 të këtij neni, ministria i kërkon ministrisë kompetente për çështjet e drejtësisë që të verifikojë të dhënat nga regjistri gjyqësor se kundër personit juridik dhe personit përgjegjës të tij ose personit fizik-tregtarit nuk ka padi të ngritur as nuk është shpallur ndonjë vendim i formës së prerë për veprime të kundërligjshme me mallrat ushtarake ose mallrat joushtarake vdekjeprurëse sipas neneve 84 dhe 85 të këtij ligji.
- (4) Ministria merr një vendim për regjistrim në regjistrin sipas paragrafit 1 të këtij neni.

(5) Vendimi sipas paragrafit 4 të këtij neni nuk mund të ankimohej, por mund të paraqitet për gjykim administrativ.

Neni 31.

(1) Ministria kundërshton regjistrimin në regjistrin e përmendur në nenin 29 paragrafi 1 të këtij neni në rast se:

- janë paraqitur informacione ose dokumente të rreme,
- gjatë 10 vjetëve të fundit, aplikanti ka shkelur rregullat për tregtinë e mallrave ushtarake ose të mallrave joushtarake vdekjeprurëse.
- gjatë 10 vjetëve të fundit, aplikanti ka shkelur sanksionet ndërkombëtare,
- aplikanti është nën hetim policor për shkelje që lidhet me tregtimin e paligjshëm të mallrave ushtarake ose mallrave joushtarake vdekjeprurëse.
- është nisur një proces hetimor ose penal për veprime të kundërligjshme me mallrat ushtarake ose mallrat joushtarake vdekjeprurëse sipas neneve 84 dhe 85 të këtij ligji.
- është ngritur padi ose personi ka qenë dënuar për veprime të kundërligjshme me mallrat ushtarake ose mallrat joushtarake vdekjeprurëse sipas neneve 84 dhe 85 të këtij ligji.
- ekzistojnë dyshime të arsyetuara ose vërtetohet se personi juridik ose personi përgjegjës i personit juridik apo personit fizik-tregtarit, ose një person tjetër i punësuar nga personi juridik ose tregtari, ka negociuar ose ka lidhur kontratë me një person, kompani ose organizatë për të cilën është vërtetuar ose ekzistojnë dyshime të arsyetuara se është i përfshirë ose në çfarëdo lloj mënyre ka bashkëpunuar në veprime të paligjshme që lidhen me mallra ushtarake ose mallra joushtarake vdekjeprurëse,
- ekzistojnë arsye të tjera të justifikuara.

(2) Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të ankimohej, por mund të dërgohet për gjykim administrativ.

Neni 32.

(1) Ministria lëshon një vendim për kundërshtim të regjistrimit në regjistrin e përmendur në nenin 29 paragrafi 1 të këtij neni, nëse:

- zbulohen fakte dhe/ose rrethana të reja të cilat, nëse do të ishin ditur në momentin e regjistrimit në regjistër, do të kishin qenë arsye për regjistrimin e personit në regjistër,
- kundër personit juridik ose personit përgjegjës të tij, apo kundër tregtarit ose ndërmjetësit ka nisur një hetim për veprime të paligjshme me mallrat ushtarake ose mallrat joushtarake vdekjeprurëse.
- personi përgjegjës i personit juridik ose personit fizik-tregtarit është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale që lidhen me pronësinë ose i është dhënë apo është në fuqi një masë e përkohshme që e ndalon atë të angazhohet në veprimtari të cilat përfshihen plotësisht ose pjesërisht në objektin e aktivitetit të tij.
- nuk vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji,
- shkel sanksionet ndërkombëtare,
- ndërpret ushtrimin e aktivitetit,

- nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave është lëshuar vendimi për regjistrim në regjistër,
- ekzistojnë dyshime të arsyetuara ose vërtetohet se personi juridik ose personi përgjegjës në personin juridik apo personin fizik-tregtarin, ose një person tjetër i punësuar nga personi juridik ose tregtari ka negociuar ose ka lidhur kontratë me një person, kompani ose organizatë për të cilën është vërtetuar ose ekzistojnë dyshime të arsyetuara se është përfshirë ose ka bashkëpunuar në çfarëdo lloj mënyre në veprime të paligjshme me mallra ushtarake ose mallra joushtarake vdekjeprurëse,
- kërkohet nga personi i regjistruar në regjistër.

(2) Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të ankimohet, por mund të dërgohet për gjykim administrativ.

Neni 33.

(1) Përpara se të fillojë të ofrojë shërbime, personi i regjistruar në regjistrin e përmendur në nenin 29 paragrafi 1 të këtij ligji duhet të aplikojë në ministri për leje për ofrimin e shërbimeve.

(2) Leja sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet nga ministria, pas miratimit nga Komisioni, për çdo aktivitet të veçantë, me afat vlefshmërie deri në një vit, pa mundësi shtyrjeje.

(3) Ministri përcakton formën dhe përmbajtjen e autorizimi sipas paragrafit 1 të këtij neni.

(4) Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen nëse asistenca teknike e ofruar është në formën e informacionit të disponueshëm për publikun ose është pjesë e kërkimeve shkencore thelbësore, si dhe nëse bëhet fjalë për ofrim të shërbimeve për nevojat e ministrisë kompetente për mbrojtjen ose të ministrisë kompetente për punët e brendshme të Republikës së Kroacisë.

Neni 34.

(1) Kërkesa për lëshimin e autorizimit për veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve paraqitet pranë ministrisë, me formularin të përcaktuar.

(2) Ministri përcakton me rregullore formën dhe përmbajtjen e formularit sipas paragrafit 1 të këtij neni, si dhe listën e dokumenteve që duhen bashkëlidhur me kërkesën në fjalë.

Neni 35

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për ofruesit e shërbimeve të cilët veprojnë në kuadër të misioneve ushtarake ose humanitare, në bazë të vendimit të ministrisë kompetente për mbrojtjen apo të një organi tjetër kompetent.

Neni 36.

Komisioni e miraton kërkesën e përmendur në nenin 34 paragrafi 1 të këtij ligji brenda 15 ditëve pas dorëzimit të kërkesës ose brenda 45 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës, nëse procedura e lëshimit të autorizimit kërkon kryerjen e verifikimeve shtesë.

Neni 37.

(1) Ministria e lëshon autorizimin e kërkuar për ofrim të shërbimeve sipas nenit 33 paragrafi 2 të këtij ligji brenda shtatë ditësh pas marrjes së miratimit nga Komisioni.

(2) Ministria nuk do të shpjegojë shkaqet e vendimin për refuzim të kërkesës nëse këto shkaqe lidhen me informacion i cili, sipas ligj ose në bazë të kritereve të konfirmuara me ligj, është informacion i

klasifikuar me një shkallë të caktuar konfidencialiteti ose është informacion i mbrojtur nga ligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale."

(3) Nëse Komisioni nuk e miraton kërkesën e parashtruar sipas nenit 15 paragrafi 1 të këtij ligji, ministria merr vendimin e refuzimit të kërkesës, i cili nuk mund të ankimohet, por mund të dërgohet për gjykim administrativ.

Neni 38.

(1) Ministria, me anë të një vendimi, e refuzon kërkesën për lëshim të lejes për ofrim shërbimesh sipas nenit 33 paragrafi 2 të këtij ligji nëse Komisioni nuk e miraton kërkesën e paraqitur për shkak se ka vërtetuar se lëshimi i lejes së kërkuar do të ishte në kundërshtim me interesat e politikës së jashtme ose ekonomike të Republikës së Kroacisë ose konfirmon se lëshimi i lejes të kërkuar është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dokumentin e përmendur në nenin 2 nënparagrafi 3 të këtij ligji, si dhe në rastet e mëposhtme, nëse:

- lëshimi i autorizimit do rrezikonte përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Kroacisë,
- lëshimi i autorizimit do të rrezikonte sigurinë ose interesat e mbrojtjes të Republikës së Kroacisë,
- lëshimi i autorizimit është në kundërshtim me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Kroacisë,
- lëshimi i autorizimit do të zhvillonte ose të shkaktonte vazhdimin e konflikteve të armatosura në shtetin përdorues fundor,
- lëshimi i autorizimit do të nxiste trazira në shtetin përdorues fundor,
- lëshimi i autorizimit do t'u mundësonte *personave të padëshiruar* të marrin mallrat e eksportuara, në kundërshtim me dëshirën e eksportuesit
- vërtetohet se mallrat për të cilat kërkohet autorizim eksporti janë objekt i hetimeve policore ose proceseve gjyqësore.

(2) Nëse kërkesa ka mangësi të cilat bëjnë të pamundur kryerjen e veprimeve sipas kërkesës ose nëse kërkesa është e pakuptueshme ose jo e plotë dhe aplikanti nuk i korrigjon pasaktësitë brenda afatit të caktuar, autoriteti kompetent e refuzon kërkesën me anë të një vendimi.

(3) vendimi sipas paragrafit 2 të këtij neni mund të dërgohet më shkrim, me postë elektronike ose personalisht dhe do të mbahet shënim.

(4) Vendimi sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nuk mund të ankimohen, por mund të dërgohen për gjykim administrativ.

Neni 39.

Personat sipas nenit 10 paragrafi 1 të këtij ligji, të cilët kryejnë veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve për mallrat ushtarake, duhet të:

- mbajnë një regjistër të veçantë për transaksionet e kryera sipas këtij ligji dhe të ruajnë dokumentacionin dhe informacionet lidhur me shërbimet e ofruara në bazë të dispozitave të këtij ligji për të paktën 20 vjet pas ofrimit të shërbimit,

- respektojnë afatet dhe kushtet sipas të cilave është lëshuar autorizimi i përmendur në nenin 33 të këtij ligji dhe të informojnë ministrinë me shkrim për çdo ndryshim të ndodhur, brenda 10 ditëve nga data e ndryshimit:
- njoftojnë ministrinë me shkrim ose me postë elektronike lidhur veprimet e ndërmarra në përputhje me autorizimin dhe bashkëlidhin dokumentacionin mbi bazën e të cilit është ofruar shërbimi, brenda 15 ditëve pas ofrimit të shërbimeve ose pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së autorizimit,
- të respektojnë kushtet e autorizimit dhe dispozitat e këtij ligji.

Neni 40.

Dokumentacioni i përmendur në nenin 39 nënparagrafi 3 të këtij ligji duhet të përmbajë informacion mbi shërbimin e ofruar, kopjen e autorizimin mbi bazën e të cilit është ofruar shërbimi dhe kopjen e dokumenteve lidhur me ofrimin e shërbimit.

Neni 41.

(1) Personi i përmendur në nenin 10 paragrafi 1 të këtij ligji hiqet nga regjistri i përmendur në nenin 29 paragrafi 1 të këtij ligji kur:

- vërtetohen fakte të reja të cilat, nëse do të diheshin në momentin e regjistrimit në regjistrin e përmendur në nenin 29 paragrafi 1 të këtij ligji nuk do të përbënin arsye për mosregjistrimin e tij,
- personi përgjegjës i personit juridik ose personit fizik-tregtarit është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale që lidhen me pronësinë ose i është dhënë apo është në vijim masa e sigurisë ndalim i kryerjes së veprimtarisë e cila plotësisht ose pjesërisht është e përfshirë nga objekti i tij i veprimtarisë.
- personi juridik ose personi përgjegjës i personit juridik ose personit fizik-tregtarit është dënuar me vendim të formës së prerë për veprime të paligjshme me mallra ushtarake ose mallra joushtarake vdekjeprurëse,
- nuk vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji,
- shkel sanksionet ndërkombëtare,
- ndërpret ushtrimin e aktivitetit,
- nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi,
- ekzistojnë dyshime të arsyetuara ose vërtetohet se personi juridik ose personi përgjegjës i personit juridik apo personit fizik-tregtarit ose n tjetër person i punësuar nga personi juridik ose tregtari ka negociuar ose ka lidhur kontratë me një person, kompani ose organizatë për të cilën është vërtetuar ose ekzistojnë dyshime të arsyeshme se është e përfshirë ose ka bashkëpunuar në çfarëdo lloj mënyre në veprime të paligjshme me mallra ushtarake ose mallra joushtarake vdekjeprurëse,
- kërkohet nga personi i regjistruar në regjistër.

(2) Ministria merr vendim për heqjen e personit nga regjistri i përmendur në nenin 29 paragrafi 1 i këtij ligji,

(3) Vendimi sipas paragrafit 2 të këtij neni nuk mund të ankimohet, por mund të dërgohet për gjykim administrativ.

V. TRANSFERIMI I PRODUKTEVE TË MBROJTJES BRENDË BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 42.

(1) Ky kapitull përcakton rregullat dhe procedurat për transferimin e produkteve të mbrojtjes brenda bashkimit Evropian, llojet e autorizimeve për transferim, detyrimet e furnizuesve dhe marrësve të produkteve të mbrojtjes, si dhe procedurën dhe kriteret për lëshimin e autorizimeve përkatëse.

(2) Dispozitat e këtij kapitulli nuk zbatohen për produktet e mbrojtjes të cilat vetëm sa kalojnë nëpërmjet territorit të Republikës së Kroacisë ose për produktet e mbrojtjes të cilat nuk u nënshtrohen procedurave doganore ose të cilat shfrytëzojnë procedurën e transitit të jashtëm ose vetëm futen në zonën e lirë doganore ose në depon e lirë doganore, dhe që nuk duhen regjistruar në regjistrin e përcaktuar të mallrave.

Autorizimi për transferim

Neni 43.

(1) Për transferimin e produkteve të mbrojtjes midis shteteve anëtare të Bashkimit Evropian duhet të merret autorizim për transferim, i cili lëshohet nga ministria, me miratim paraprak nga Komisioni.

(2) Komisioni e jep miratimin për transferim në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën procedurë sipas të cilës jep miratimin për lëshimin e autorizimeve për eksport dhe import të mallrave ushtarake ose të mallrave joushtarake vdekjeprurëse,

(3) Autorizimi për transferim mund të jetë i përgjithshëm, global dhe i veçantë.

Neni 44.

Si përjashtim nga neni 45 paragrafi 1 i këtij ligji, nuk kërkohet autorizim për transferim të produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian në rastet kur furnitori dhe marrësi janë organe qeveritare ose pjesë e forcave të armatosura të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, kur furnizimi kryhet nga Bashkimi Evropian, NATO, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike ose organizata të tjera ndërkombëtare për kryerjen e detyrave të tyre, si dhe kur transferimi lidhet me ndihmat humanitare të organit shtetëror në rast fatkeqësish natyrore ose si donacion për raste emergjencash.

Neni 45.

Duke bërë përjashtim nga neni 43 paragrafi 1 i këtij ligji:

– ministria kompetente për mbrojtjen lëshon autorizime të veçanta për transferim të produkteve të mbrojtjes për nevojat e Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, ndërsa ministria kompetente për punët e brendshme lëshon leje për blerje të produkteve të mbrojtjes për nevojat e policisë.

– ministria kompetente për mbrojtjen lëshon autorizim për transferim të produkteve të mbrojtjes për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, me synimin për t'i kthyer sërish në shtetin tonë, ndërsa ministria kompetente për punët e brendshme lëshon autorizim për transferim të produkteve të mbrojtjes për nevojat e policisë, me synimin për t'i kthyer sërish në shtetin tonë.

– autorizime individuale për transferim të produkteve të mbrojtjes në bazë të donacioneve të qeverisë lëshohen nga ministria kompetente për çështjet e mbrojtjes ose nga ministria kompetente për punët e brendshme, në rast se bëhet fjalë për mallra që janë kompetencë e saj.

– autorizimet për transferim nuk kërkohen nga personat fizikë-qytetarët, të cilët, për nevojat e tyre dhe pa regjistrim në regjistrë, mund të transferojnë produktet e mbrojtjes për të cilat ministria kompetente për punët e brendshme ka dhënë autorizim e blerjes së tyre.

Neni 46.

Pa cenuar zbatimin e rregulloreve të posaçme për rendin ose sigurinë publike, për transitin apo futjen e produkteve të mbrojtjes në territorin e Republikës së Kroacisë nuk nevojitet autorizim për transferim.

Neni 47.

Autorizimi për transferim mund t'i lëshohet vetëm një personit juridik ose fizik-tregtari, i cili është regjistruar në regjistrin e përmendur në nenin 10 paragrafi 1 i këtij ligji.

Neni 48.

Furnizuesi ose marrësi që kryen transferimin e produkteve të mbrojtjes mund të përdorë një autorizim të përgjithshëm transferimi ose të kërkojë autorizim global ose individual për transferim të produkteve të mbrojtjes nga ministria.

Neni 49.

(1) Autorizimi për transferim të pjesëve përbërëse të produkteve të mbrojtjes lëshohet në bazë të vlerësimit të ndjeshmërisë së transferimit, në përputhje me kriteret për natyrën e pjesëve përbërëse në raport me produktin e mbrojtjes në të cilin do të vendosen dhe përdorimin fundor të produktit përfundimtar, i cili mund të përbëjë shqetësim për sigurinë kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe për rëndësinë e pjesëve përbërëse në raport me produktin mbrojtës në të cilin do të vendosen.

(2) Nuk do të vendosen kufizime në transferimin e pjesëve përbërëse nëse një transferim i tillë nuk konsiderohet se ndikon në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë rast, marrësi duhet t'i dorëzojë ministrisë një deklaratë në të cilën konfirmohet se komponentët për të cilët është lëshuar autorizimi për transferim janë vendosur ose do të vendosen në produkti e tij personal dhe se nuk do transferohet ose eksportohen si të tilla në fazat e mëtejshme, përveçse për nevoja mirëmbajtjeje ose riparimi.

Autorizimi i përgjithshëm për transferim

Neni 50.

(1) Ministria lëshon autorizim të përgjithshëm për transferim, me anë të cilit furnizuesit e vendosur në territorin e Republikës së Kroacisë të cilët përmbushin kushtet e përcaktuara në autorizim, lejohen të transferojnë produktet e mbrojtjes të përfshira në autorizimin në fjalë të marrës të vendosur në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

(2) Ministria lëshon autorizim të përgjithshëm për transferim, me anë të të cilit marrësit e vendosur në territorin e Republikës së Kroacisë të cilët përmbushin kushtet e përcaktuara në autorizim lejohen që të transferojnë produktet e mbrojtjes të përfshira në autorizim nga furnizues të vendosur në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

Neni 51

Ministria lëshon autorizim të përgjithshëm për transferim në rastet kur:

- marrësi është një pjesë e forcave të armatosura të një shteti anëtar i Bashkimit Evropian ose e një organi që furnizon armë për nevojat e forcave të armatosura të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian,
- marrësi është një kompani e certifikuar,
- transferimi kryhet për qëllime demonstrimi, prove ose ekspozimi.

– transferimi kryhet për qëllime mirëmbajtjeje ose riparimi dhe marrësi është furnitori fillestar i produkteve të mbrojtjes.

– transferimi kryhet për pjesëmarrje në programe bashkëpunimi midis shteteve anëtare të Bashkimit Evropian lidhur me zhvillimin, prodhimin dhe përdorimin e një ose më shumë produktesh mbrojtëse, rast në të cilin autorizimi shpallet përpara të gjitha shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian pjesëmarrëse në këtë program.

Neni 52.

Ministria e publikon autorizimin e përgjithshëm për transferim në faqen e saj të internetit.

Autorizimi global për transferim

Neni 53.

(1) Ministria, me kërkesë të një furnizuesi të caktuar, mund të lëshojë autorizim global për transferim të produkteve të mbrojtjes të marrës në një ose më shumë shtete të Bashkimit Evropian.

(2) Ministria, me kërkesë të një marrësi të caktuar, lëshon autorizim global për transferim të produkteve të mbrojtjes nga furnitori në një ose më shumë shtete të Bashkimit Evropian.

(3) Në çdo autorizim global për transferim të produkteve të mbrojtjes ose të një kategorie produktesh mbrojtëse të specifikuar në autorizim, Ministria do përcaktojë marrësit ose kategoritë e marrësve.

(4) Ministri, me anë të një rregulloreje, përcakton formën dhe përmbajtjen e autorizimit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe listën e dokumenteve që duhet t'i bashkëlidhen kërkesës.

Neni 54.

(1) Kur lëshon autorizim global për transferim, ministria merr në konsideratë llojin e produktit të mbrojtjes, kohëzgjatjen e aktiviteteve të transferimit dhe, nëse furnitori/marrësi ka ngritur një program harmonizimi të brendshëm me të cilin konfirmohen rregullat e veprimit dhe përgjegjësitë brenda kompanisë në lidhje me transferimin e produkteve të mbrojtjes.

(2) Ministri, me anë të një rregulloreje, përcakton elementet bazë që duhet që të përmbajë programi i harmonizimit të brendshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 55.

Autorizimi global për transferim lëshohet për një afat deri në tre vjet, me mundësi rinovimi për të njëjtin afat dhe me të njëjtat kushte.

Autorizimi individual për transferim

Neni 56.

(1) Ministria, me kërkesë nga një furnizuesi i veçantë, mund të lëshojë autorizim të veçantë për transferim me vlefshmëri deri në një vit, me anë të të cilit lejon transferimin e një sasive të caktuar produktesh mbrojtëse, në një ose disa dërgesa, të një marrës në një shtet tjetër të Bashkimit Evropian.

(2) Ministria, me kërkesë nga një marrës i caktuar, mund të lëshojë autorizim individual për transferim me vlefshmëri deri në një vit, me anë të të cilit lejon transferimin e një sasive të caktuar produktesh, mbrojtëse në një ose në disa dërgesa, nga një furnitor drejt një shteti tjetër të Bashkimit Evropian

(3) Autorizimi individual për transferim lëshohet nëse:

- kërkesa për autorizim kufizohet vetëm në një transfertë,
- nevojitet për mbrojtjen e interesave themelore të Republikës së Kroacisë ose për sigurimin e rendit publik,
- nevojitet për të siguruar përputhshmërinë me marrëveshje ndërkombëtare,
- ekzistojnë dyshime të arsyetuara se furnitori nuk do ketë mundësi të plotësojë të gjitha kushtet e nevojshme për miratimin e autorizimi global për transferim.

(4) Ministri, me anë të një rregulloreje, përcakton formën dhe përmbajtjen e autorizimit individual sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe listën e dokumenteve që duhet t'i bashkëlidhen kërkesës.

(5) Ministria e lëshon ose refuzon autorizimin individual të kërkuar për transferim, me anë të një vendimi dhe në afatin dhe mënyrën e përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji.

(6) Vendimi sipas paragrafit 5 të këtij neni nuk mund të ankimohet, por mund të dërgohet për gjykim administrativ.

Neni 57.

(1) Me kërkesë të marrësit, në bazë të deklaratës me shkrim mbi përdoruesin fundor dhe qëllimin e transferimit, Ministria lëshon dhe certifikatën e përdoruesit fundor.

(2) Nëse marrësi është i ndryshëm nga përdoruesi fundor, përveç dokumenteve të kërkuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të bashkëlidhet edhe deklarata e përdoruesit fundor lidhur me llojin, sasinë dhe qëllimin e produkteve të mbrojtjes.

(3) Certifikata e përdoruesit fundor për transferim të produkteve të mbrojtjes për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë lëshohet nga ministria kompetente për mbrojtjen,

(4) Certifikata e përdoruesit fundor për transferim të produkteve të mbrojtjes të synuara për policinë lëshohet nga ministria kompetente për punët e brendshme.

(5) Ministri, me anë të një rregulloreje, përcakton formën dhe përmbajtjen deklaratës dhe të certifikatës sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Detyrimet e furnizuesit dhe të marrësit

Neni 58.

Furnizuesi i produkteve të mbrojtjes duhet të informojë marrësin për kushtet e autorizimit për transferim, duke përfshirë kufizimet lidhur me përdorimet fundore ose eksportin e produkteve të mbrojtjes.

Neni 59.

(1) Furnizuesi ose marrësi i produkteve të mbrojtjes duhet të njoftojë ministrinë me shkrim, të paktën 15 ditë përpara përdorimit të autorizimit të përgjithshëm për transferim të produkteve të mbrojtjes.

(2) Ministria mund t'i kërkojë furnizuesit ose pritësit që të dorëzojë të dhëna shtesë pas përdorimit për herë të parë të autorizimit të përgjithshëm, të cilat justifikojnë përdorimin e drejtë të tij.

Neni 60.

Furnizuesi ose marrësi duhet të mbajë të dhëna të detajuara dhe të plota për transferimet që kryen, si dhe të informoje ministrinë mbi përdorimin e autorizimit së përgjithshëm, global ose të pjesshëm për transferim. Të dhëna të tilla përfshijnë dokumentet që përmbajnë informacionet si vijon:

- listën e produkteve të mbrojtjes dhe kodin e tij sipas listës së produkteve të mbrojtjes,
- sasinë dhe vlerën e produkteve të mbrojtjes,
- datën e transferimit,
- emrin dhe adresën e furnizuesit dhe të marrësit,
- përdorimin fundor, nëse dihet, dhe përdoruesin fundor të tyre,
- dëshmi që informacioni mbi kufizimin e eksportit, i përcaktuar në autorizimin për transferim, i është dërguar marrësit të produktit të mbrojtjes.

Neni 61.

(1) Personi juridik ose fizik-tregtari, i cili ka marrë autorizim global ose të pjesshëm për transferim, ose i cili ka përdorur një autorizim të përgjithshëm për transferim, duhet të njoftojë ministrinë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike mbi kryerjen e transferimit, brenda 15 ditësh nga transferimi i kryer, si dhe të bashkëlidhë dokumentacionin në bazë të cilit është kryer transferimi.

(2) Dokumentacioni sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë:

- informacion mbi transferimin e kryer,
- kopjen e autorizimit,
- kopjen e deklaratës doganore (në rast se transferimi i produkteve të mbrojtjes është paraprirë nga importimi mallrave në Republikën e Kroacisë),
- numrat e serisë të armëve,
- dokumente të tjera në varësi të llojit të mallit.

(3) Përdoruesi i autorizimit global ose të pjesshëm për transferim duhet t'i dërgojë ministrisë dy herë në vit, brenda datës 15 korrik të vitit aktual dhe brenda datës 15 janar të vitit pasues, t'i dërgojë, me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike, pasqyrën përmbledhëse të transferimeve të kryera.

Neni 62.

Të dhënat e paraqitura në nenin 60 të këtij ligji, furnizuesi ose pritësi duhet t'i ruajë të paktën për 20 vjet pas vitit kalendarik në të cilin është kryer transferimi dhe paraqesë ato ministrisë sipas kërkesës.

Neni 63.

Marrësi i produkteve të mbrojtjes në Republikën e Kroacisë ka detyrimin që, në rastin e paraqitjes së kërkesës për lëshimin e autorizimit për eksport të këtyre produkteve të mbrojtjes, të njoftojë të njoftojë ministrinë me shkrim se produkti i marrë sipas autorizimit për transferim nga një shtet tjetër anëtar i Bashkimit Evropian ka kufizime eksporti dhe se kanë respektuar kushtet e këtyre kufizimeve, përfshirë, sipas rastit, duke marrë miratimin e kërkuar nga shteti anëtar i Bashkimit Evropian.

Certifikimi

Neni 64.

- (1) Ministria i lëshon certifikatë personit juridik dhe personit fizik-tregtarit me seli ne territorin e Republikës së Kroacisë i cili do të marrë produktet e mbrojtjes sipas autorizimit të përgjithshëm për transferim, të lëshuar nga një shtet tjetër anëtar i Bashkimit Evropian.
- (2) Certifikata lëshohet mbi bazën e kërkesës me shkrim të aplikantit.
- (3) Ministri, me anë të një rregulloreje, përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës për lëshim të certifikatës, si dhe formën dhe përmbajtjen e kësaj të fundit.

Neni 65.

- (1) Certifikata e lëshuar vërteton besueshmërinë e marrësit, veçanërisht për sa i përket aftësisë së tij për të respektuar kufizimet lidhur me eksportin e produkteve të mbrojtjes të marra në bazë të autorizimit për transferim nga një shtet tjetër anëtar i Bashkimit Evropian.
- (2) Besueshmëria e marrësit vlerësohet sipas kritereve të mëposhtme:
 - përvoja e treguar me aktivitetet e lidhura me produktet e mbrojtjes, duke marrë në konsideratë veçanërisht respektimin e kufizimeve të eksportit nga ana e marrësit, çdo lloj vendimi gjyqësor lidhur me to, autorizimin për prodhim apo tregtim të produkteve të mbrojtjes, si dhe punësimin e personelit administrativ me përvojë.
 - zotërimi i aktiviteti të rregullt industrial në prodhimin e produkteve të mbrojtjes dhe veçanërisht i aftësisë për integrimin e sistemeve ose të nënsistemeve,
 - emërimi i personi në funksion drejtues si një punonjës i veçantë përgjegjës për transferimin dhe eksportin,
 - paraqitja e një deklarate me shkrim nga shoqëria, të nënshkruar nga personi në funksion drejtues sipas nënparagrafit 3 të këtij paragrafi, që kompania ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për respektimin dhe zbatimin e të gjitha kushteve të veçanta lidhur me përdorimin fundor dhe eksportin e çdo lloj komponenti ose produkti të marrë në dorëzim.
 - deklarata me shkrim nga drejtuesi i një shoqërie sipas nënparagrafit 3 të këtij paragrafi, që konfirmon se shoqëria organit kompetent i ka dërguar informacion të detajuar si përgjigje ndaj kërkesave dhe pyetjeve mbi përdorimin fundor të të gjitha produkteve të eksportuara, të transferuara ose të marra në bazë të autorizimit për transferim, të lëshuar nga një shtet tjetër anëtar i Bashkimit Evropian,
 - disponimi të një programi harmonizimi të brendshëm ose sistemit për administrimin e eksportit dhe transferimit, të integruar në aktivitetin e kompanisë dhe të nënshkruar nga drejtuesi sipas nënparagrafit 3 të këtij paragrafi. Programi duhet të përmbajë detaje mbi burimet organizative, njerëzore dhe teknike për administrimin e transferimit dhe eksportit, zinxhirin e përgjegjësive brenda kompanisë, veprimet e auditit të brendshëm, aftësimin e personelit, masat e sigurisë fizike e teknike, mbajtjen e regjistrit dhe ndjekjen e transferimit dhe të eksportit.

Neni 66

- (1) Certifikata sipas neni 64 paragrafi 1 të këtij ligji përmban të dhënat si vijon:
 - emrin e organit kompetent që ka lëshuar certifikatën,
 - emrin dhe adresën e marrësit,

– deklaratën e marrësit në përputhje me kriteret sipas nenit 65 paragrafi 2 të këtij ligji,

– datën e lëshimit dhe afatin e vlefshmërisë së certifikatës.

(2) Afati i vlefshmërisë së certifikatës nuk duhet të jetë më shumë se pesë vjet.

(3) Personi juridik ose fizik-tregtari që kërkon zgjatjen e vlefshmërisë së certifikatës sipas nenit 64 paragrafi 1 të këtij ligji duhet të paraqesë kërkesë me shkrim pranë ministrisë, 60 ditë përpara skadimit të vlefshmërisë së certifikatës.

Neni 67.

Certifikata e përmendur në nenin 64 paragrafi 1 të këtij ligji mund të përmbajë kushte shtesë për të dhënat e kërkuara për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret sipas nenit 65 paragrafi 2 të këtij ligji, si dhe kushtet për pezullimin ose revokimin e certifikatës.

Neni 68.

Ministria ka detyrimin që të verifikojë përputhshmërinë e kriterëve për besueshmërinë e marrësit me kriteret e përcaktuara në nenin 65 paragrafi 2 të këtij ligji, si dhe përputhshmërinë me kushtet e certifikatës së përmendur në nenin 66 paragrafi 1 të këtij ligji.

Neni 69.

Ministria njeh çdo certifikatë të lëshuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian të regjistruar në regjistrin qendror të marrësve, e cila e mbahen nga Komisioni Evropian.

Neni 70.

(1) Nëse ministria vërteton se mbajtësi i certifikatës sipas nenit 64 paragrafi 1 të këtij ligji i vendosur në territorin e Republikës së Kroacisë nuk i plotëson më kushtet sipas nenit 66 paragrafi 1 të këtij ligji, mund të pezullojë zbatimin e certifikatës së dhënë.

(2) Ministria ka detyrimin që për vendimin e saj sipas paragrafit 1 të këtij neni të njoftojë Komisionin Evropian dhe shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian.

Neni 71.

Ministria e publikon dhe përditëson rregullisht, në faqet e saj të internetit, listën e marrësve të certifikatave dhe informon për këtë Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian dhe shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian.

Procedurat doganore

Neni 72.

Procedura e eksportit nga territori i Republikës së Kroacisë e produkteve të mbrojtjes të marra nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian mbi bazën e autorizimit të lëshuar për transferim të produkteve të mbrojtjes të integruara në një produkt tjetër të mbrojtjes mund të shtyhet për një kohëzgjatje deri në 30 ditë ose, nëse është e nevojshme, të pezullohet nëse gjatë lëshimit të autorizimit për eksport nuk janë marrë parasysh të gjitha dhënat e përkatëse dhe/ose nëse që nga data e lëshimit të autorizimit në fjalë rrethanat kanë ndryshuar në mënyrë të qenësishme.

Lista e produkteve të mbrojtjes dhe raportimi

Neni 73.

Qeveria, me propozim të ministrisë, miraton listën e produkteve të mbrojtjes të harmonizuar me listën e produkteve të mbrojtjes të përcaktuar nga Komisioni Evropian.

Neni 74.

Ministria, deri më 30 prill të vitit aktual, përgatit raportin vjetor mbi transferimin e produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian për vitin pararendës dhe ia dërgon qeverisë për miratim.

Masat mbrojtëse

Neni 75.

Nëse ministria, gjatë procesit të lëshimit të autorizimit për transferim të produkteve të mbrojtjes, konfirmon se ekziston një rrezik real që një marrës i certifikuar në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian nuk do të përmbushë kushtet e autorizimit të përgjithshëm për transferim të produkteve të mbrojtjes ose se mbi bazën e rregullave të veçanta do të rrezikohet rendi publik, siguria ose interesat themelore të Republikës së Kroacisë, ajo njofton për këtë shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian dhe kërkon të gjitha verifikimet shitesë të nevojshme.

Neni 76.

(1) Nëse ministria vazhdon të ketë dyshimet e përmendura në nenin 75 të këtij ligji, ajo pezullon zbatimin e autorizimit të përgjithshëm për transferim të produkteve të mbrojtjes të marrësi.

(2) Ministria mund të vendosë që ta anulojë masën mbrojtëse sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse gjykon se nuk ka më baza për zbatimin e saj.

(3) Ministria informon shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian dhe Komisionin Evropian për shkaqet e miratimit ose anulimit të masës mbrojtëse në fjalë.

VII. MBIKËQYRJA

Neni 77.

(1) Ministria mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve sipas këtij ligji në bashkëpunim me organet e tjera të përfshira në procesin e lëshimit të autorizimeve dhe me organet e tjera kompetente.

(2) Mbikëqyrja sipas këtij ligji përfshin mbikëqyrjen përpara, gjatë dhe pas lëshimit të autorizimit.

(3) Nëse konstatohen parregullsi, ministria njofton organet kompetente për procedim të mëtejshëm.

Neni 78.

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, organet mbikëqyrëse sipas nenit 77 paragrafi 1 të këtij ligji mund të:

– kërkojnë nga aplikantët informacionet e nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes,

– kërkojnë nga organet dhe shërbimet e tjera shtetërore informacionet e nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes,

– kërkojnë ndihmë nga organet kompetente të shteteve të tjera për grumbullim të informacioneve shitesë të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes,

– mbikëqyrin përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara në autorizim,

– mbikëqyrin përdoruesin fundor të mallrave.

(2) Organet mbikëqyrëse sipas nenit 77 paragrafi 1 të këtij ligji veprojnë në përputhje me dispozitat për konfidencialitetin e të dhënave të personave që i nënshtrohen mbikëqyrjes.

Neni 79.

Për nevojat e kryerjes së detyrave të përcaktuara me këtë ligj, Ministria, në kuadër të kompetencave që i jep ky ligj, bashkëpunon edhe me organet e tjera të administratës shtetërore dhe me agjencitë e sigurisë, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe organet kompetente të shteteve të tjera, të cilave u dërgohen të dhënat përkatëse, në përputhje me detyrimet e marra nga Republika e Kroacisë.

Neni 80.

(1) Ministria bashkëpunon në shkëmbimin e informacioneve rreth transportit të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse me shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian.

(2) Bashkëpunimi përfshin dhe shkëmbimin e informacioneve mbi transferimin e produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian, si dhe regjistrimin e ofruesve të shërbimeve dhe aktiviteteve të tyre.

VIII. DISPOZITAT PENALIZUESE

PENALITETET

Neni 81.

(1) Personat juridikë dënohen me gjobë në vlerën 50 000,00 deri në 500 000,00 kuna për kundërvajtje, nëse:

– kryen eksport-import të mallrave sipas këtij ligji, pa qenë i regjistruar për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të mallrave dhe pa u regjistruar në regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (neni 10 paragrafi 1)

– nuk aplikon për regjistrim në regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (neni 10 paragrafi 6)

– nuk njofton me shkrim të gjitha ndryshimet e të dhënave mbi bazën e të cilave personi juridik është regjistruar në regjistër, brenda 15 ditëve nga data e ndodhjes së ndryshimeve (neni 12),

– autorizimin ose ndonjë dokument tjetër të marrë sipas këtij ligji ia jep një personi tjetër (neni 18),

– nuk mban regjistër të veçantë për transaksionet që kryen në bazë të këtij ligji dhe nuk ruan dokumentet e transaksioneve e të transportit për të paktën 20 vjet nga kryerja e eksportit ose importit; nuk respekton afatet dhe kushtet me të cilat janë lëshuar autorizimet dhe nuk informon me shkrim ministrinë për çdo ndryshim të ndodhur brenda 10 ditëve pas ndodhjes së ndryshimit (neni 26 nënparagrafi 1)

– nuk ministrinë për eksportin ose importin e kryer brenda 15 ditëve pas kryerjes tij, me shkrim ose nëpërmjet postës elektronik, dhe nuk bashkëlidh dokumentacionin mbi bazën e të cilit është kryer eksportimi ose importimi (neni 26 nënparagrafi 2),

– nuk paraqet vërtetimin e marrjes në dorëzim të mallrave, pas kërkesës nga ministria (neni 26 nënparagrafi 3),

– nuk respekton kushtet e autorizimit dhe dispozitat e këtij ligji (neni 26 nënparagrafi 4),

– nuk mban regjistër të veçantë për shërbimet dhe nuk ruan të gjitha dokumentet dhe informacionet lidhur me ofrimin e shërbimeve në bazë të dispozitave të këtij ligji për të paktën 20 vjet pas ofrimit të shërbimit (neni 39 nënparagrafi 1)

– nuk respekton afatet dhe kushtet mbi të cilat është lëshuar autorizimi sipas nenit 33 të këtij ligji dhe nuk informon me shkrim ministrinë për çdo ndryshim të ndodhur brenda 10 ditësh pas ndodhjes së ndryshimit (neni 39 nënparagrafi 2)

– nuk njofton ministrinë me shkrim ose postë elektronike për aktivitete e kryera sipas autorizimit dhe nuk bashkëlidh dokumentacionin mbi bazën e të cilit është ofruar shërbimi (neni 39 nënparagrafi 3), brenda 15 ditëve pas ofrimit të shërbimit ose pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së autorizimit sipas nenit 33 paragrafi 2 i këtij ligji,

– nuk respekton kushtet e autorizimit dhe dispozitat e këtij ligji (neni 39 nënparagrafi 4),

(2) Me dënim në të holla në shumën 20 000,00 deri në 200 000,00 kuna dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse në deklaratën doganore sipas nenit 27 nënparagrafi 3 të këtij ligji nuk vendos të dhënat e përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.

(3) Për kundërvajtje sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni personi fizik-tregtari dënohet me gjobë në shumën 10 000,00 deri në 100 000,00 kuna

(4) Për kundërvajtje sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, personi përgjegjës në personin juridik dënohet me gjobë në shumën 5000,00 deri në 50 000,00 kuna

(5) Me dënim në të holla në shumën prej 5000,00 deri në 50 000,00 kuna do dënohet personi fizik – qytetari që importon mallra pa marrë leje për blerje arme nga ministria kompetente për punët e brendshme (neni 10 paragrafi 2).

Neni 82

(1) Personat juridikë dënohen me gjobë në shumën 50 000,00 deri në 500 000,00 kuna nëse:

– nuk informojnë marrësin për kushtet e autorizimit për transferim, përfshirë kufizimet lidhur me përdorimin fundor ose eksportimin e produkteve të mbrojtjes (neni 58),

– nuk njofton ministrinë me shkrim të paktën 15 ditë përpara përdorimit të autorizimit për transferim të produkteve të mbrojtjes (neni 59 paragrafi 1),

– nuk dërgojnë të dhënat shtesë të kërkuara nga ministria që justifikojnë të drejtën e përdorimit të autorizimit të përgjithshëm për transferim në momentin e përdorimit për herë të parë të autorizimit (neni 59 paragrafi 2),

– nuk njoftojnë ministrinë, me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike, për transferimin e kryer brenda 15 ditëve pas kryerjes së tij, dhe nuk bashkëlidh dokumentacionin mbi bazën e të cilit është kryer transferimi (neni 61 paragrafi 1 dhe 2),

– nuk i dërgojnë ministrisë raportin përmbledhës të transferimeve të kryera, me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike, dy herë në vit, përkatësisht brenda datës 15 korrik të vitit aktual dhe brenda datës 15 janar për vitin vijues (neni 61 paragrafi 3),

– nuk i ruan të dhënat e përcaktuara në nenin 61 paragrafi 2 të këtij ligji për të paktën 20 vjet pas vitit kalendarik në të cilin është kryer transferimi dhe nuk ia dërgon ministrisë, pas kërkesës (neni 62),

– kur aplikojnë për lëshimin e autorizimit për eksport të produkteve të mbrojtjes, nuk informon ministrinë me shkrim se produktet e marra në bazë të autorizimit për transferim nga një shtet tjetër anëtar i Bashkimit Evropian ka kufizime eksporti dhe nëse nuk ka respektuar kushtet kufizimeve, përfshirë, sipas rastit, që nuk ka marrë miratimin e shtetit anëtar të Bashkimit Evropian (neni 63),

(2) Personat juridikë dënohen me gjobë në shumën 20 000,00 deri në 200 000,00 kuna nëse nuk mbajnë të dhëna të detajuara dhe të plota mbi transferimet që kanë kryer dhe nuk informojnë ministrinë mbi përdorimin e autorizimit të përgjithshëm, global ose individual për transferim (neni 60).

(3) Për kundërvajtje sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, personi fizik-tregtar dënohet me gjobë në shumën 10 000,00 deri në 100 000,00 kuna

(4) Për kundërvajtjet sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë në shumën 5000,00 deri në 50 000,00 kuna

Veprat penale

Neni 83.

(1) Personat që eksportojnë ose importojnë mallra të përfshira në listën e mallrave ushtarake sipas nenit 4 të këtij ligji pa autorizim ose në bazë të një certifikate përdoruesi fundor false, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.

(2) Me sanksionet sipas paragrafit 1 të këtij dënohen personat që ofrojnë shërbime ndërmjetësimi sipas nenit 3 pika 11 të këtij ligji, pa autorizim.

(3) Me sanksionet sipas paragrafit 1 të këtij neni dënohen personat që transferojnë mallra të përfshira në listën sipas nenit 73 të këtij ligji, pa autorizim ose në bazë të certifikatës false të përdoruesit fundor.

(4) Nëse vepra penale sipas paragrafëve 1, 2 ose 3 të këtij neni ka shkaktuar vdekjen e një ose më shumë personave apo dëme të mëdha materiale, autori i veprës dënohet me burgim për të paktën pesë vjet.

Neni 84.

(1) Personat që eksportojnë ose importojnë armët, pjesët e armëve, municionet dhe pjesët e municioneve ose lëndët plasëse të përfshira në listën e mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare sipas nenit 4 të këtij ligji, pa autorizim ose në bazë të certifikatës false të përdoruesit fundor, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.

(2) Nëse vepra penale sipas paragrafëve 1, 2 ose 3 të këtij neni ka shkaktuar vdekjen e një ose më shumë personave dëme të mëdha materiale, autori dënohet me burgim për të paktën pesë vjet.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 85.

Të gjitha procedimet e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do përfundojnë sipas dispozitave të ligjit për eksportin dhe importin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (Fletorja zyrtare nr. 86/08.).

Neni 86.

Rregullat sipas neneve 4 dhe 73 të këtij ligji qeveria i miraton brenda tetë ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 87.

(1) Ministri e miraton rregulloren sipas neneve 7, 8, 9, 10, 15, 29, 33, 34, nenit 53 paragrafi 4, nenit 54 paragrafi 2, nenit 56 paragrafi 4, nenit 57 paragrafi 5 dhe nenit 64 paragrafi 3 të këtij ligji brenda tetë ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në datën e hyrjes në fuqi të rregullave sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të zbatohen sipas rastit:

– Dispozita për listën e mallrave ushtarake dhe listën e mallrave joushtarake vdekjeprurëse ("Fletorja zyrtare nr. 89/12.).

– Rregullorja për formularin për lëshimin e autorizimeve për eksport ose import të mallrave të ushtarake dhe listën e mallrave joushtarake vdekjeprurëse ("Fletorja zyrtare nr. 1/09. dhe 26/13.).

– Rregullorja për formularin për lëshimin e autorizimeve për ofrim shërbimesh ("Fletorja zyrtare nr. 1/09.dhe 26/13.).

– Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të eksportuesve dhe importuesve të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse ("Fletorja zyrtare nr. 1/09.dhe 26/13.).

– Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe të autorizimit të përgjithshëm për eksport të mallrave ushtarake të kategorisë ML13 ("Fletorja zyrtare nr. 1/09.dhe 26/13.).

– Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e autorizimit për ofrim të shërbimeve në lidhje me mallrat ushtarake ("Fletorja zyrtare nr. 1/09 dhe 26/13).

– Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e certifikatës së përdoruesit fundor për import të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare ("Fletorja zyrtare nr. 1/09 dhe 26/13).

– Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e autorizimit për eksport ose import të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare ("Fletorja zyrtare nr. 1/09 dhe 26/13).

– Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të ofruesve të shërbimeve lidhur me mallrat ushtarake ("Fletorja zyrtare nr. 1/09 dhe 26/13).

Neni 88.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji për eksportin dhe importin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse ("Fletorja zyrtare nr. 86/08).

Neni 89

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit të tij në "Fletoren zyrtare", përveç dispozitave të neneve 42 deri në 53 paragrafët 1, 2 dhe 3, nenit 54 paragrafi 1, nenit 55, nenit 56 paragrafët 1, 2, 3, 5 dhe 6, nenit 57 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, nenit 58 deri në 71 dhe neneve 74 deri në 76 të këtij ligji, të cilat hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të Kroacisë në Bashkimin Evropian.

Kategoria: 022-03/13-01/118

Zagreb, më 21 qershor 2013

PARLAMENTI KROAT

Kryetari
i Parlamentit KROAT
Josip Leko d.v.